

# STATUTI

## I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Vitus HealthCare" shpk.

### KAPITULLI I FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

#### Neni 1

##### Forma

1. Sot me date 02.05.2024 Shoqëria "Vitus HealthCare" shpk (në vijim "Shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.
2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
3. Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

#### Neni 2

##### Emërtimi

1. Emërtimi i Shoqërisë është "Vitus HealthCare" Sh.p.k.
2. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

#### Neni 3

##### Objekti i shoqërisë

1. Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
2. Në mënyrë më specifike, aktiviteti bazë i kësaj Shoqërie do të jetë :

-Tregtimi i bimeve medicinale me shumice dhe pakice, import eksport, tregtim i artikujve te ndryshem te konsumit te gjere industrial dhe ushqimore, prodhime bujqesore dhe blegtorale,import eksport te lendeve te para , materialeve, pajisjeve dhe makinerive,te pjeseve te kembimit,per to me shumice e pakice, import te prodhimeve farmaceutike dhe pajisjeve mjekesore si dhe tregitmin e tyre me shumice e pakice, transport nderkombetar te mallrave,operacione tregtare e komisionere, dhenie garancive te ndryshme ndaj cdo pale te trete. Laborator per prodhime farmaceutike. Prodhim i barnave per njerez.

#### **Neni 4 Selia**

1. Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga e Kavajes, Shetitorja Murat Toptani , Z.Kadastrale 8150 , Nr.Pasurie 1/251, Kati 2.
2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.
3. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë ose në shtete të tjera.

#### **Neni 5 Kohëzgjatja e veprimtarisë**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë për një afat të papërcaktuar.

### **KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, ORTAKET, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE**

#### **Neni 6 Kapitali themeltar dhe ortaku i vetëm**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 Lek
2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuote , e nënshkruar dhe e shlyer, me vlerë nominale 10.000 Lek.
3. Ortaku i shoqërisë:
  1. **Z.Xhuljan Guce**, i datëlindjes 19.07.1996 , lindur në Bilisht, dhe banues në *Tirane* , mbajtës i Leternjoftimit me nr.J60719071E.
4. Përgjegjësia e secilit ortakut shtrihet deri në shumën e kontributit në kapitalin themeltar.

#### **Neni 7 Kontributet**

1. Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
  - **Z.Xhuljan Guce** ,ka ofruar një kontribut në para të barabartë me \_\_\_\_\_
- 2.
3. Sipas kontributeve të mësipërme:
  - **Z.Xhuljan Guce**, ka të drejtën 1 kuotë, që i korrespondon 100% (Njëqind) të kapitalit të Shoqërisë.

#### **Neni 8 Rritja e kapitalit themeltar**

1. Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas rasteve të parashikuara në ligjin nr.9901 me datë

14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

2. Në rast rritjeje të kapitalit, ortakët merr vendim për rritjen e kapitalit .

### **Neni 9**

#### **Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

1. Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
2. Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga ortakët e Shoqërisë.

### **Neni 10**

#### **Transferimi i kuotave**

1. Kuotat janë lirisht të transferueshme.
2. Kuotat transformohen në çdo lloj forme si:
  - a) me shitje
  - b) dhurim\trashëgimi
  - c) çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj
3. Në një rast të tillë ortakët që do të transferojë kuotën e tij, duhet të njoftoj ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t’i referohet të gjitha kuotave të ofruara për shitje.
4. Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t’i komunikuar ortakët që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
5. Në rast se oferta pranohet nga disa ortakët, kuotat e ofruara nga ortakët që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rasteve kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
6. Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t’u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Përgjithshme.
7. Në rast të transferimit të kuotave për shkak trashëgimie *mortis causa* ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet pëlqimi, kuotat mund t’u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht.

## **KAPITULLI III**

### **ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL**

#### **Neni 11**

#### **Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj**

1. Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme
2. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër të parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.

## **Neni 12**

### **E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës**

1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron.
2. Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
3. Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

## **Neni 13**

### **Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi dhe vendimet**

1. Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
2. Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve si dhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit të ortakëve të paktën 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi rendin e ditës në lidhje me çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e mbledhjes.
3. Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë.
4. Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar, të cilët janë dakord të marrin vendime pavarësisht parregullsisë së njoftimit.
5. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat është e nevojshme një shumicë e zakonshme, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat është e nevojshme një shumicë e cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar.
6. Asambleja e Përgjithshme vendos për ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve dhe dividendëve, përcakton politikat tregëtare dhe ekonomike të shoqërisë dhe mbikqyr zbatimin e këtyre të fundit nga Administratori, emëron dhe shkarkon administratorin, emëron dhe shkarkon ekspertin (ët) kontabël dhe/ose likujduesin (ët) e Shoqërisë, përcakton shpërblimin e administratorit, ekspertëve kontabël dhe likujduesve, mbikqyr dhe miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga administratori, autorizon një ose disa persona të jashtëm të përfaqësojnë shoqërinë në proceset gjyqësore, miraton rregullat procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuar nga ky statut dhe legjislacioni në fuqi, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë me votën pro të të paktën  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) të ortakëve pjesëmarrës, të cilët përfaqësojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Përgjithshme merr vendimet në mbledhje të zakonshme me votën pro të shumicës së ortakëve të pranishëm që përfaqësojnë mbi 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar.
7. Asambleja drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja.

Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

8. Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari dhe regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve. Bazuar nw parashikimet ligjore njw kopje e vendimit dwrgohet pwr regjistrim pranw Qendrws Kombwtare tw Biznesit.

#### **Neni 14 Administrimi**

1. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë, të cilët do të veprojnë si veçmas ashtu edhe bashkërisht. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje.
2. Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë u besohet Administratorëve. Administratorët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit nr.9901 të datës 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
3. Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.
4. Administratori i Shoqërisë është:

- **Z.Xhuljan Guce**, i datëlindjes 19.07.996, lindur në Bilisht, dhe banues në *Tirane*, mbajtës i Leternjoftimit me nr. J60719071E, ortak i shoqërisë, **i cili do të qëndrojë në detyrë për një periudhë 5 vjecare nga dt 02.05.2024 der me 02.05.2029 me të drejtë ripërtëritjeje.**

5. Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve me nënshkrimin e administratorit.
6. Administratori i Shoqërisë administron veprimtarinë e shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme, përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me çdo palë të tretë, merr masa për hartimin dhe mbajtjen në mënyrën e duhur të pasqyrave financiare dhe të dokumentave, përgatit dhe nënshkruan pasqyrat vjetore financiare dhe bilancet e konsoliduara, përgatit raportin e ecurisë dhe i dorëzon këto të fundit bashkë me propozimin përkatës për shpërndarjen e fitimeve në Asamblenë e Përgjithshme për miratim, krijon sistemin e paralajmërimit në lidhje me rrethanat të cilat kërcënojnë veprimtarinë e Shoqërisë, dorëzon në QKB dokumentat dhe të dhënat e Shoqërisë përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe, raporton në Asamblenë e Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe në lidhje me përmbushjen e transaksioneve të një rëndësie të veçantë për ecurinë e Shoqërisë, kryen çdo detyrë tjetër të parashikuar nga ligji ose nga ky statut, është i autorizuar për të siguruar mjetet financiare dhe kredi, të lidhë marrëveshje përkatëse me banka, institucione krediti ose financiare vëndase ose të huaja, duke përdorur si mjete garancie në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi asetet e Shoqërisë.

#### **Neni 15 Eksperti kontabël i autorizuar**

1. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t' i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
2. Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

## **KAPITULLI IV**

### **VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

#### **Neni 16**

##### **Viti financiar dhe bilanci vjetor**

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
2. Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
3. Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe të ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga ligji nr.9901 me datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar.
4. Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga fundi i vitit financiar ose brenda afateve të parashikuar nga legjislacioni tatimor.

#### **Neni 17**

##### **Fitimet**

1. Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruar.
5. Fitimet ndahen në formën e dividendëve paslëshimkit të ertifikatës pagueuse në përputhje me ligji nr.9901 me datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar dhe legjilacionin tatimor në fuqi.
2. Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve plotësisht ose pjesërisht për vitet financiare të ardhshme.

## **KAPITULLI V**

### **SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

#### **Neni 18**

##### **Prishja e Shoqërisë**

1. Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
2. Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

#### **Neni 19**

##### **Likuidimi**

1. Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
2. Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
3. Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

4. Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

**Neni 20**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
2. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Shkallës së Parë, Juridiksioni Përgjithshëm Tiranë.

**ORTAK I VETEM**

**XHULJAN GUCE**